

## AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) që prej vitit 2002 është institucioni përgjegjës për administrimin e skemës së sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë.

ASD siguron depozitat tuaja në çdo bankë dhe kompenson ato deri në nivelin maksimal 2.500.000 lekë, në rast se banka nuk është më në gjendje të paguajë depozitat tuaja.

Të gjithë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë janë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Anëtarësimi i tyre në skemë është i detyrueshëm.

**PËRFITUES** nga skema e sigurimit është çdo depozitues: individ, tregtar dhe shoqëri tregtare, rezident ose jorezident, shqiptar ose i huaj, i cili ka llogari depozitë në një bankë, në lekë ose në monedhë të huaj, sipas ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.

## PROCESI I KOMPENSIMIT

### I. Nisin Procedurat e Kompensimit.

Procedurat e kompensimit fillojnë menjëherë, kur ASD njoftohet me shkrim nga Banka e Shqipërisë për vendosjen e bankës në likuidim të detyruar. Depozituesit do të njoftohen nga Agjencia në lidhje me procesin e kompensimit të depozitave.

### II. Përgatitja e ASD-së për kompensim.

ASD merr të dhënat për depozitat dhe depozituesit nga likuidatori dhe përgatit listë pagesën me të dhënat e depozituesve me shumat përkatëse për kompensim. ASD dërgon listën pagesën së bashku me fondet tek banka agjente, në të cilën do të kryhen pagesat për kompensim. Agjencia njofton depozituesit në lidhje me fillimin e procesit të kompensimit, si dhe mënyrën e kryerjes së tij.

### III. Kryerja e pagesës

Banka Agjente kryen pagesën sipas udhëzimeve të Agjencisë për të gjithë depozituesit që përfitojnë nga kompensimi i depozitave, nëpërmjet:

- Pagesës me para në dorë në sportelet e saj (depozituesi individ)
  - Depozitimit në një llogari bankare në Bankën Agjente ( depozitues individ/tregtar/shoqëri tregtare)
  - Transferts në një bankë tjetër (individ/tregtar/shoqëri tregtare)
- \* Çdo depozitues individ, tregtar apo shoqëri tregtare, për të përfituar pagesën në sportelet e Bankës Agjente duhet të identifikohet, nëpërmjet:
- Dokumentit të identifikimit me të cilin është identifikuar në Bankën e vendosur në likuidim.

### IV. Mbyllja e procesit

Procesi i kompensimit përfundon jo më vonë se 3 muaj nga data e fillimit të tij. Agjencia njofton depozituesit për mbylljen e procesit të kompensimit si dhe vijon me trajtimin e ankesave. Çdo

depozitues, që nuk është paraqitur për t'u kompensuar brenda afatit ligjor të kompensimit, i ruhet e drejta për kompensim, brenda 10 vjetëve.

### DEPOZITAT E SIGURUARA

Agjencia siguron dhe kompenson **ÇDO DEPOZITUES, NË ÇDO BANKË** deri në nivelin maksimal ligjor **2.500.000 lekë**, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës.

#### ASD SIGURON:

- ✓ Depozita me afat
- ✓ Depozita pa afat
- ✓ Llogari rrjedhëse
- ✓ Llogari kursimi
- ✓ Depozita apo llogari të tjera bankare, kombinime të produkteve bankare të sipërcituara, të sigurueshme nga Agjencia

**DEPOZITUESIT NUK KANË ASNJË KOSTO** për sigurimin e depozitave të tyre. Bankat kanë detyrimin ligjor të paguajnë për sigurimin e depozitave pranë Agjencisë.

### DEPOZITAT E PASIGURUESHME

- Depozitat e bankës, degës së bankës së huaj, në emër dhe për llogari të vet, si dhe çdo subjekt tjetër financiar i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Depozitat e drejtorit, administratorit në bankë dhe familjarëve të tyre, sipas certifikatës së gjendjes familjare;
- Depozitat e çdo personi që zotëron 5 për qind ose më shumë në kapitalin e subjektit anëtar ose të aksioneve me të drejtë vote në këtë subjekt;
- Depozitat e prejardhura nga veprimtari të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat janë deklaruar të paligjshme me vendim gjykate të formës së prerë;
- Depozitat e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, vendase ose të huaja;
- Depozitat e subjekteve të sipërmarrjes ose investimeve kolektive, vendase ose të huaja;
- Depozitat e fondeve të pensionit ose sigurimit pensional, vendase ose të huaja;
- Tituj të emetuar nga subjekte financiare dhe çdolloj detyrimi tjetër që këto subjekte kanë bazuar mbi marrëveshjet e tyre të premtimit;
- Depozitat e njësisve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe çdo enti publik të Republikës së Shqipërisë ose të një vendi të huaj;
- Depozitat të paemëtuara dhe/ose titulli i të cilave nuk përcaktohet qartë;
- Depozitat e vendosura në subjektin anëtar të skemës së sigurimit të depozitave gjatë dhe pas ditës së ngjarjes së sigurimit në këtë subjekt;
- Depozitat e personave juridikë, përveç atyre të përcaktuara në pikën 17 neni 3 të ligjit.

## **ÇFARË SIGUROHET!**

### **Ju keni disa llogari në të njëjtën bankë, në lekë ose në monedhë të huaj.**

Depozitat tuaja janë të siguruara në lekë dhe në monedhë të huaj. Këto të fundit konvertohen në lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në ditën e vënies së bankës në likuidim të detyruar. Ju përfitoni kompensim deri në 2.500.000 lekë.

Shuma që përfitoni është: Totali i depozitave tuaja, përfshirë edhe interesin deri në ditën e vënies së bankës në likuidim, duke zbritur shumën e detyrimeve ndaj bankës, të papaguara në kohë nga ana juaj.

### **Ju keni disa llogari në disa banka.**

Ju kompensoheni deri në 2.500.000 lekë në secilën bankë.

### **Ju keni një llogari të përbashkët.**

Secili depozitues zotëron pjesë të barabarta në depozitën e përbashkët, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kontratën e depozitës. Kompensimi që përfiton secili bashkëpronar, deri në 2.500.000 lekë, përfshin shumat në llogaritë personale që mund të ketë si edhe pjesën që i takon nga llogaria e përbashkët.

### **Ju jeni një individ që keni llogari personale dhe llogari të biznesit tuaj në të njëjtën bankë.**

Ju do të kompensoheni deri në 2.500.000 lekë për secilën prej tyre.

*\*Në çdo rast, shuma e mbetur e depozitës mbi 2.500.000 lekë, nuk kompensohet nga Agjencia. Për këto shuma, Ju mund ti adresoheni Likuidatorit të emëruar nga Banka e Shqipërisë.*

## **IDENTIFIKOHU!**

Identifikimi korrekt i secilit depozitues është element kyç për të mundësuar kompensim të shpejtë dhe të saktë. Çdo neglizhencë lidhur me të dhënat e depozituesve do të vështirësojë e vonojë procesin.

Të dhënat minimale që çdo depozitues duhet të regjistrojë në bankë në mënyrë që të mos ketë asnjë pengesë për të përfituar atë që i takon, janë:

### **INDIVID**

- emri, mbiemri
- numri i dokumentit të identifikimit
- atësia
- numri personal
- datëlindja
- adresa
- numri i telefonit

### **TREGTAR OSE SHOQËRI TREGTARE**

- numri unik i identifikimit subjektiv
- data e regjistrimit
- emërtimi
- forma ligjore



BANKA KOMBETARE TREGTARE



AGJENCIA  
E SIGURIMIT  
TË DEPOZITAVE

**Ju lutemi të:**

- ✓ Depozitoni një kopje të dokumentit të identifikimit në bankë;
- ✓ Njoftoni menjëherë bankën për çdo ndryshim të të dhënave të mësipërme;
  
- ✓ Depozitoni nënshkrimin apo firmën dhe nënshkruani/firmosni çdo dokument bankar që tregon apo autorizon lëvizjet nga llogaria depozitë e juaj;
- ✓ Njoftoni Agjencinë për çdo parregullsi që vëreni në drejtim të mbajtjes së të dhënave tuaja të mësipërme dhe të procesit të identifikimit tuaj.